

**VENDIM****Nr. 724, datë 2.11.2014**

**PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT
BUXHETOR AFATMESEM, TË
RISHIKUAR, 2015-2017**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 25, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e programit buxhetor afatmesëm, të rishikuar, për periudhën 2015-2017, sipas dokumentit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

PROGRAMI BUXHETOR AFATMESEM, I
RISHIKUAR, PËR PERIUDHËN 2015-2017

PËRMBLEDHJE

Dokumenti i Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2015 – 2017 përbën finalizimin e fazës së dytë të procesit të përgatitjes së kërkesave buxhetore afatmesme 2015 – 2017, proces ky i iniciuar përmes vendimeve të Këshillit të Ministrave nr. 34, datë 29.01.2014 “Për miratimin e kuadrit makroekonomik e fiskal për periudhën 2015-2017”, si dhe vendimit nr. 528, datë 6.8.2014 “Për tavanet përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2015-2017”.

Si çdo vit, i gjithë procesi është drejtuar dhe koordinuar nga Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS), i cili është ngritur në çdo njësi të qeverisjes qendrore në bazë të urdhrit të Kryeministrit nr. 78, datë 8.5.2006, “Për krijimin e grupeve ministrore të punës për strategi, buxhet dhe integrim, “GSBP”, i ndryshuar”, ku një rol të veçantë ka luajtur koordinatori i GMS (nëpunësi autorizues/sekretari i Përgjithshëm) në çdo njësi të qeverisjes qendrore. Në mënyrë të ngjashme, në përputhje me udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 29.3.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe udhëzimin nr. 7/2, datë 04.07.2014 “Për përgatitjen e PBA-së 2015 – 2017”, është drejtuar dhe organizuar ky

proces edhe në institucionet e tjera buxhetore.

Dokumenti i PBA-së 2015 – 2017 paraqet në detaje qëllimet, objektivat dhe produktet e programeve të secilës prej ministrive të linjës, për vitet 2015, 2016 dhe 2017. Kështu, ky dokument ka mundur të realizojë për një kuadër afatmesëm lidhjet mes qëllimeve dhe objektiveve të politikave, me shpërndarjen e burimeve buxhetore, përkatësisht në nivel programi.

Është e rëndësishme për t’u theksuar fakti se me rritjen progresive të vëmendjes kushtuar procesit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2015 – 2017, kapaciteti i menaxhimit po përmirësohet vazhdimisht me kalimin e kohës. Gjithashtu, sistemi i planifikimit të integruar dhe veçanërisht Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim janë bazat e forcimit të vazhdueshëm të procesit të PBA, nëpërmjet sigurimit të informacionit të nevojshëm në nivel strategjik të politikave.

Në vijim, projekt-dokumenti i Programit Buxhetor Afatmesëm, 2015 – 2017 është i strukturuar në tre kapituj:

- Kapitulli i parë përshkruan rolin e PBA si një instrument i menaxhimit të shpenzimeve publike, pjesë përbërëse e sistemit të planifikimit të integruar, si dhe termat kohorë që procesi i PBA-së ndjek gjatë vitit buxhetor;

- Kapitulli i dytë përshkruan kuadrin makro-ekonomik dhe fiskal për periudhën 2015 – 2017;

- Kapitulli i tretë paraqet në mënyrë të përmbledhur informacionin e siguruar nga ministrinë e linjës lidhur me kërkesat buxhetore afatmesme 2015–2017 dhe konkretisht qëllimet e politikës, objektivat dhe produktet për secilin prej programeve të tyre për vitet 2015, 2016 dhe 2017.

Gjithashtu, në këtë dokument përfshihen edhe 2 anekse shoqëruese të strukturuar si më poshtë:

Aneksi 1: Tavanet e shpenzimeve buxhetore 2015 – 2017, në nivel programi për ministrinë e linjës;

Aneksi 2: Tavanet e shpenzimeve buxhetore 2015 – 2017, në nivel grup-artikujsh të shpenzimeve, për çdo njësi të qeverisjes qendrore;

Hyrje

A.1 Roli i Programit Buxhetor Afatmesëm

1. Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument operacional për menaxhimin e shpenzimeve publike dhe një komponent kyç i Sistemit të Planifikimit të Integruar. Ai është rezultat i dy proceseve: rishikimit të politikave dhe



planifikimit të shpenzimeve dhe investimeve të Programit. Planet e shpenzimeve hartohen nga njësitë e qeverisjes qendrore brenda burimeve që Qeveria ka në dispozicion. Ky dokument përdoret për të informuar Kuvendin e Shqipërisë dhe publikun e gjerë lidhur me planet e shpenzimeve të Qeverisë për tri vitet e ardhshme, të cilat do të çojnë në arritjen e objektivave politike të Qeverisë. Ai përcakton kontekstin afatmesëm të buxhetit vjetor.

2. Qëllimet kryesore të PBA-së janë:

- Inkurajimi i efektivitetit, efijencës dhe ekonomisë në kryerjen e shpenzimeve publike;
- Lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet prioritetëve strategjiko-politike të Qeverisë me shpërndarjen e burimeve publike dhe kryerjen e shpenzimeve publike;
- Promovimi i disiplinës fiskale duke mundësuar që shpenzimet publike të planifikohen brenda një kuadri realist makroekonomik dhe fiskal;
- Zgjerimi i vizionit të procesit buxhetor duke siguruar që programet e shpenzimeve të planifikohen në një periudhë afatmesme (3-vjeçare).

Dokumenti i PBA-së hartohet nga Ministria e Financave dhe i jep mundësinë Këshillit të Ministrave për të zhvilluar një kuadër të qartë burimesh brenda periudhës afatmesme, që do të shërbejë si bazë për planifikimin e shpenzimeve publike korrente dhe kapitale.

Gjithashtu, ai i shërben njësive të qeverisjes qendrore dhe fondeve speciale të tyre, pasi mundëson përcaktimin prej tyre të politikave dhe programeve në një strukturë koherente, si dhe mundësinë për të përcaktuar kostot dhe prioritetet e tyre brenda kontekstit të burimeve të disponueshme, në mënyrë që burimet financiare të mund të alokohen tek programet prioritare në periudhën afatmesme.

Duhet theksuar gjithashtu se procesi i hartimit të PBA-së është i orientuar mbi bazën e performancës. Përparësitë e kësaj mënyre të re të konceptimit të planifikimit të shpenzimeve konsistojnë në përfundimin e:

- kontributit të qartë të produkteve në përmbushjen e objektivave të politikës;
- produkteve të matshme;
- aktiviteteve të kostueshme.

Procesi i hartimit të dokumentit të PBA-së u realizua nga një bashkëpunim i ngushtë ndërmjet Ministrisë së Financave me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Departamentin e Programimit të Zhvillimit të Financimeve dhe të Ndihmës së Huaj, në Kryeministri dhe Ministrinë e Integritimit.

A.2 Programi Buxhetor Afatmesëm dhe Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integritim

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integritim, me një horizont planifikimi prej 7 vitesh, përcakton strategjitë dhe synimet afatshkurtra dhe afatgjata për të gjithë sektorët, bazuar në një vizion kombëtar. Ky program do t'i shërbejë edhe arritjes së aspiratave të SKZHI-së për integrimin europian.

Për procesin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2015–2017, elementi strategjik i PBA-së u siguria nëpërmjet konsultimit të strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale përgjatë procesit të rishikimit të politikës së Programit–përcaktimi i qëllimeve dhe objektivave për çdo program buxhetor të ministrive të linjës.

A.3 Procesi i përgatitjes së PBA-së 2015–2017

Tabela 1 paraqet në mënyrë të përmblëdhur hapat kryesorë në procesin e përgatitjes së PBA-së 2015–2017, të ndërmarrë në përputhje me kalendarin e Sistemit të planifikimit të integruar dhe kalendarin e menaxhimit të shpenzimeve publike për vitin 2015, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 36, datë 29.1.2014.

Tabela 1 Fazat e përgatitjes së PBA-së

FAZAT	KOHA	PËRSHKRIMI
1. Kuadri makroekonomik, vendosja e prioritetëve dhe përgatitja e tavanëve të PBA-së për çdo njësi të qeverisjes qendrore dhe fondet speciale.	Tremujori I	Përgatitja e tavanëve të përgjithshme dhe vendosja e treguesve makroekonomikë përmes parashikimit makroekonomik. Identifikimi i prioritetëve të politikave dhe zërave me ndikim të rëndësishëm në shpenzime e të ardhura (pagat, transfertat vendore, programet e reja, projektet kryesor të investimeve publike). Vendosja e tavanëve përgatitore të PBA-së. Përgatitja e udhëzimit për përgatitjen e PBA-së.


Qeveria miraton parashikimin makroekonomik dhe fiskal, tavanet e përgjithshme dhe tavanet përgatitore të PBA-së 3-vjeçare për çdo njësi të qeverisjes qendrore dhe fondet speciale të tyre

2. Rishikimi i politikës së Programit (RPP).	Tremujori II	Njësitë e qeverisjes qendrore përcaktojnë politikat për çdo program dhe identifikojnë qëllimet dhe objektivat e programit.
3. Planifikimi i shpenzimeve dhe investimeve të Programit (PSHIP).	Tremujori II	Brenda tavanëve të miratuara, njësitë e qeverisjes qendrore zhvillojnë PSHIP duke identifikuar produktet dhe duke i kostuar aktivitetet në bazë të fondeve në dispozicion për çdo program.

Qeveria miraton projektdokumentin e PBA-së

4. Përgatitja e buxhetit	Tremujori III	Përgatitja e udhëzimit plotësues për përgatitjen e PBA. Njësitë e qeverisjes qendrore paraqesin kërkesat buxhetore afatmesme të rishikuara.
--------------------------	---------------	--

Qeveria miraton projektin e PBA-së të rishikuar dhe projektligjin e buxhetit vjetor dhe i dërgon në Kuvend përkatësisht për informim dhe miratim

5. Shqyrtimi në Kuvend	Tremujori IV	Shqyrtimi dhe miratimi i ligjit vjetor të buxhetit nga Kuvendi.
------------------------	--------------	---

Shënim: Dokumenti përfundimtar i PBA-së publikohet në fillim të vitit pasardhës pas miratimit të ligjit vjetor të buxhetit nga Kuvendi.

A.3.1 Rishikimi i politikës së Programit (RPP)

Nevoja kryesore për një menaxhim efektiv të financave publike është përcaktimi i qartë i politikave. Për politikat e reja kjo mund të arrihet nëpërmjet zbatimit të një procesi të mirë të përcaktimit të politikave, domethënë nëpërmjet përmirësimit të hartimit të politikave.

Procesi i PBA-së merr një rëndësi parësore në përpjekjet e Qeverisë për të lidhur buxhetin vjetor me politikat e tij. Për të arritur këtë, politikat duhet të jenë të qarta, të kuptueshme dhe të rishikohen rregullisht nëpërmjet një procesi të rishikimit të politikës së programit, i cili është i integruar me procesin e planifikimit të shpenzimeve dhe investimeve, përcaktimit të kostove dhe përgatitjes së buxhetit.

A.3.2 Planifikimi i shpenzimeve dhe investimeve të Programit (PSHIP)

Planifikimi i shpenzimeve dhe investimeve të Programit është pjesë e planifikimit strategjik dhe pason rishikimin e politikës së Programit. Ai përfaqëson pjesën kryesore të procesit të përgatitjes së PBA-së. PSHIP ndërmerret në kontekstin e politikës makroekonomike dhe veçanërisht të nevojës për stabilitet fiskal.

Ai realizohet gjithashtu në kontekstin e prioriteteve strategjike të Qeverisë dhe të qëllimeve dhe objektivave të politikës të përcaktuara për çdo sektor, domethënë nëpërmjet rishikimit të politikës së Programit, PSHIP reflekton mënyrën se si Qeveria dëshiron t'i alokojë burimet e saj për secilin sektor.

Një hap i rëndësishëm për të garantuar që

procesi i PSHIP-së të jetë në përputhje me kuadrin makroekonomik e fiskal dhe prioritetet strategjike të Qeverisë, është vendosja e tavanëve të shpenzimeve, që përbën kufirin maksimal që mund të shpenzohet ose të planifikohet për t'u shpenzuar, për një qëllim të caktuar. PSHIP ndërmerret nga ministrinë e linjës duke përdorur sistemin e informatizuar të Ministrisë së Financës për Planifikimin e Shpenzimeve dhe Investimeve të Programeve. Për njësitë e qeverisjes qendrore që nuk kanë akses në sistemin e informatizuar, planifikimi i shpenzimeve mundësohet nëpërmjet formateve përkatëse të përcaktuara në udhëzimin e përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm.

A.4 Roli i Ministrisë së Financave në procesin e PBA-së

Roli i Ministrisë së Financave përgjatë procesit të PBA është kryesor dhe shumë i rëndësishëm. Ministria e Financave gjatë fazës së rishikimit të politikës së Programit duhet të sigurojë që politikat, objektivat dhe qëllimet janë të përcaktuara qartë dhe se programet buxhetore dhe rezultatet e synuara do të plotësojnë objektivat dhe qëllimet e politikës në një mënyrë që krijon vlerë për para, që do të thotë përdorim të shpenzimeve publike në mënyrë ekonomike, eficiente dhe efektive.

Ndërsa, roli i Ministrisë së Financave në fazën e planifikimit të shpenzimeve dhe investimeve të Programit është i dyfishtë.

i) Dërgon propozime për tavanet e përgjithshme të shpenzimeve dhe tavanet përgatitore të PBA-së në Këshillin e Ministrave;



ii) Analiza dhe vlerësimi nëse njësitë e qeverisjes qendrore po arrijnë eficientë, efektivitetin dhe ekonomi në përdorimin e fondeve buxhetore, gjë e cila mbahet në konsideratë gjatë propozimit të taveve përgatitore të PBA-së në Këshillin e Ministrave.

A.5 Roli i Komitetit të Planifikimit Strategjik

Komiteti i Planifikimit Strategjik është një strukturë e krijuar pranë Këshillit të Ministrave, e cila kryesohet nga Kryeministri. Roli i këtij Komiteti është thellësisht koordinues dhe vendimmarrës, pasi të gjitha propozimet e rëndësishme që kanë të bëjnë me sistemin e planifikimit të integruar në përgjithësi, dhe Programit Buxhetor Afatmesëm në veçanti, kalojnë detyrimisht për shqyrtim pranë këtij Komiteti përpara se të marrin miratimin përfundimtar pranë Këshillit të Ministrave.

Në procesin e përgatitjes së PBA-së, Komiteti i Planifikimit Strategjik dhe Këshilli i Ministrave luajnë një rol parësor në drejtim të miratimit të një sërë etapash të rëndësishme të tilla si:

- kuadri makroekonomik dhe fiskal për periudhën e PBA;
- tavanet përgatitore dhe përfundimtare të PBA;
- kalendari i sistemit të planifikimit të integruar;
- projektdokumentin e PBA;
- dokumentin e PBA të rishikuar.

B. Kuadri makroekonomik dhe fiskal për periudhën 2015 – 2017

Kuadri fillestar makroekonomik e fiskal për periudhën 2015 – 2017 është pjesë e sistemit të planifikimit të integruar dhe përgatitet nga Ministria e Financave. Kuadri makroekonomik e fiskal përgatitet me qëllim që të ofrohet informacion për përcaktimin e përparësive strategjike, shpenzimeve agregate, synimeve në lidhje me të ardhurat dhe deficitin, si edhe për përcaktimin e taveve për të filluar procesin e përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm (PBA) në nivel ministrie. Kuadri fillestar makroekonomik e fiskal miratohet nga Komiteti i Planifikimit Strategjik në muajin e parë të çdo viti dhe është subjekt rishikimi dhe përditësimi në dy momente kyç gjatë vitit: në muajin maj, përpara finalizimit të PBA-së dhe të taveve të PBA-së për shpenzimet, dhe në muajin shtator,

përpara dërgimit në Parlament të projektbuxhetit të shtetit.

Kuadri makroekonomik e fiskal për periudhën 2015-2017 përbëhet nga dy pjesë kryesore. Në pjesën e parë paraqiten vlerësimet mbi zhvillimet ekonomike dhe fiskale më të fundit dhe pjesa e dytë trajton parashikimet e treguesve kryesore makroekonomik, parashikimin e burimeve në dispozicion të qeverisë dhe shpërndarjen e tyre për periudhën 2015 - 2017.

Zhvillimet makroekonomike

Kriza globale ushtroi presion të dukshëm mbi ekonominë shqiptare. Si pasojë e krizës globale, normat e rritjes u ulën ndjeshëm. Rritja reale në vitin 2009 u përgjysmua nga trendi i saj historik, por megjithatë vijoi të ishte pozitive (3.4 për qind e PBB-së), si rezultat i ekspozimit të kufizuar financiar në tregjet ndërkombëtare dhe të një politike fiskale ekspansioniste të iniciuar para krizës. Me lidhje veçanërisht të forta ekonomike e tregtare me Italinë dhe Greqinë, kriza në këto vende u reflektua në uljen e remitancave dhe eksporteve në ekonominë shqiptare, të cilat çuan në një ngadalësim të konsiderueshëm të rritjes ekonomike dhe veçanërisht të të ardhurave buxhetore.

Ekonomia ka vazhduar me një normë të moderuar rritjeje prej 3.7 për qind në vitin 2010 dhe 2.5 në vitin 2011. Në vitin 2012 dhe përgjatë vitit 2013, rritja ekonomike është dobësuar edhe më tej. Norma e rritjes ekonomike u ul në 1.6% në 2012 dhe vijoi të ulej ndjeshëm gjatë 2013. Gjatë vitit 2013 rritja ekonomike e vlerësuar prej INSTAT-it rezultoi në 1.4% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kërkesa e brendshme vijoi të ishte mjaft e dobët. Kërkesa e jashtme ka qenë gjeneratori kryesor i rritjes në dy vitet e fundit, megjithatë, ajo mbetet e kushtëzuar nga zhvillimet e pafavorshme në ekonominë e eurozonës dhe të një baze jo të diversifikuar eksportuesish si përsa i takon produkteve, ashtu edhe tregjeve.

Sektori real. Në vitin 2013 ritmi i rritjes ekonomike u reduktua edhe më tej duke regjistruar nivelin prej 1.4%. Ndryshe nga vitet e mëparshme, gjatë vitit 2013, krahasuar me vendet e Ballkanit Perëndimor, Shqipëria ishte i vetmi vend ku rritja ekonomike u ngadalësua.




	Rritja (në % TII'14/TII'13)
Bujqësia, blektori, gjuetia dhe pyjet	3.2
Industria	-1.3
Ndërtimi	-22.4
Tregti, Hotele dhe Restorante	7.1
Transporti	-23.1
Posta dhe komunikacioni	-1.0
Sherbime të tjera	4.6
PBB totale	-0.6

Burimi: INSTAT

përfshirë bankat, e rrjedhimisht përkeqësoi akoma më tej pozicionin e agjentëve ekonomikë për të vijuar normalisht me aktivitetin e tyre ekonomik.

Sektori i “Industriës nxjerrëse” ka udhëhequr aktivitetin ekonomik gjatë vitit T2 2014 me një rritje




reale prej rreth 8.8 për qind, pasuar nga “Bujqësia” me një rritje në terma realë respektivisht prej rreth 0.7 për qind. “Posta dhe komunikacioni” pësoi një rënie me 1.5% gjatë T2-2014. Ndërtimi pësoi rritje me 2.3%. “Tregti, hotele dhe restorante” dhe “Transporti” pësuan tkurje me 0.3 dhe 12.3%.

Të dhënat e papunësisë sipas Anketës Tremujore të Forcave të Punës (LFS) tregojnë se numri i personave të punësuar në moshë pune (15-64 vjeç) ishte 1,006,307. Krahasuar me një

tremujor më parë (T1-2014) ai u rrit me 70,707 persona ose 7.6 %. Ndërsa krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë (T2-2013) ai u rrit me 15,869 persona ose 1.6%

Numri i personave të papunë në moshë pune (15-64 vjeç) ishte 216,087. Krahasuar me një tremujor më parë (T1-2014) ai u rrit me 1,719 persona. Ndërsa krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë (T2-2014) ai u rrit me 21,579 persona (figura 1).

Shkalla e papunësisë në T2-2014 ishte 17.7%. Krahasuar me tremujorin e mëparshëm (T1-2014), shkalla e papunësisë u ul me 1.0 pikë përqindje. Ndërsa krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë (T2-2014), ajo u rrit me 1.3 pikë përqindje



Sektori monetar. Norma mesatare e inflacionit vjetor shënoi 1.7% në tremujorin e tretë 2014. Ambienti i përgjithshëm ekonomik e financiar gjeneron presione të ulëta inflacioniste. Faktorët e

ofertës vlerësohet të kenë ushtruar presione rënëse në inflacion gjatë këtij tremujori. Paralelisht me to, kërkesa agregate mbetet ende e pamjaftueshme për të siguruar shfrytëzim të plotë të kapaciteteve



prodhuese dhe sjell rritje të ulët të punësimit, të kostove të punës e të prodhimit, si dhe të çmimeve finale të konsumit.

Kredia për ekonominë është rritur me ritme të moderuara në tremujorin e tretë të vitit 2014. Rritja mesatare mujore prej 4.2 miliardë lekësh në muajt korrik dhe gusht ishte ecuri më e mirë, krahasuar me pjesën e parë të vitit. Ndryshimi vjetor i portofolit të kredisë ishte 2.5% në muajin gusht, duke u përmirësuar dukshëm nga ecuria vjetore e deritanishme. Ky përmirësim, krahas rritjeve mujore, ka reflektuar edhe shuarjen e efektit statistikor të pastrimit të portofolit një vit më parë 53. Pavarësisht këtij përmirësimi, aktiviteti kreditues vijon të jetë i plogësht. Ai është i kushtëzuar nga një kërkesë e moderuar për financim si nga bizneset, ashtu edhe nga individët. Sinjalet pozitive të marra nga vrojtimi kreditues i tremujorit të dytë u mbartën vetëm pjesërisht në vrojtimin e tremujorit të tretë. Tregu i kredisë vijon të jetë i karakterizuar nga një kërkesë e moderuar për kreditim, e cila pritet të vijoje edhe në pjesën e mbetur të vitit.

Gjatë muajit gusht të vitit 2014 stoku total i depozitave bankare u rrit me 1.5% krahasuar me gushtin e vitit 2013. Stoku total i depozitave në lekë ka pësuar një rënie prej 1.8%, ndërsa ai në valutë është rritur me 5.2% (gusht 2014 / gusht 2013). Në gusht 2014 rezulton se rreth 50.87% e totalit të stokut të depozitave përbëhet nga depozitat në lekë, ndërsa pjesa tjetër prej 49.13% përbëhet nga depozitimet në valutë të huaj. Stoku total i depozitave vetëm për muajin gusht 2014 shënoi një rritje prej 4.5 miliardë lekë kundrejt muajit paraardhës (korrik 2014).

Niveli i kredive me probleme deri në tremujorin e dytë të vitit 2014 ka shkuar në nivelin e 24.06%, duke pësuar një rënie prej 0.02 pikë përqindje krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2014, ndërsa krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2013 ka shënuar një rënie prej 0.33 pikë përqindje (Banka e Shqipërisë, gusht 2014).

Sektori i jashtëm. Të dhënat mbi sektorin e jashtëm të ekonomisë tregojnë për një zgjerim vjetor me rreth 10.4% të deficitit të eksporteve reale neto të mallrave e të shërbimeve në tremujorin e dytë të vitit. Ky rezultat ishte disi më i lartë se pritjet tona mbi ecurinë vjetore të këtij treguesi për tremujorin në analizë. Rol kryesor në këtë zhvillim luajti rritja e importit real me rreth

11.4% në bazë vjetore. Në terma të ndikimit në ekonomi, ecuria e regjistruar dha një kontribut negativ prej 1.4 pikësh përqindjeje në ndryshimin vjetor të kërkesës agregate, duke vijuar prirjen e nisur gjatë tremujorit të dytë të vitit 2013. Për gjysmën e dytë të vitit, parashikimet tona janë për një kontribut të vogël pozitiv të eksporteve reale neto në ecurinë e kërkesës agregate. Të dhënat më të fundit mbi ecurinë e eksporteve neto gjatë tremujorit të fundit të vitit përfshijnë vetëm komponentin e tregtisë në mallra për muajt korrik e gusht. Kështu, deficitit tregtar në mallra për këto dy muaj u zgjerua me rreth 3.9% në nivel vjetor. Vlen të theksohet se për këto dy muaj eksporti i mallrave është zvogëluar me rreth 2.3%, ndërsa importet janë zgjeruar me rreth 1%. Aktiviteti tregtar për periudhën tregon për një nivel të ngjashëm fluksesh tregtare me atë të regjistruar gjatë të njëjtës periudhe të një viti më parë. Ndërkohë, raporti i mbulimit të importeve prej eksporteve ishte në nivelin 45.2%, rreth 1.5 pikë përqindje më i ulët se një vit më parë.

Kërkesa e qëndrueshme e huaj ndihmoi në ruajtjen e prirjes rritëse të eksportit të mallrave dhe të shërbimeve. Megjithatë, ruajtja e prirjes rritëse për të tretin tremujor radhazi të importit të mallrave dhe të shërbimeve, ka ndikuar në thellimin e deficitit të eksporteve neto për këtë tremujor. Bilanci i llogarisë së të ardhurave parësore qëndroi në territor negativ për të dytin tremujor radhazi. Në anën tjetër, gjatë këtij tremujori është regjistruar një rritje prej rreth 2.6% të të ardhurave dytësore, pas pesë tremujorësh të karakterizuar nga rënie e vazhdueshme. Këtu, ndikim të rëndësishëm ka dhënë rritja vjetore e dërgesave prej emigrantëve me rreth 4%. Flukset hyrëse neto kapitale u rritën në 15.3 milionë euro, nga 9.7 milionë euro që ishin gjatë tremujorit të parë të vitit të kaluar. Flukset neto në llogarinë financiare regjistruan një rënie vjetore prej rreth 16.1%, duke financuar 64% të deficitit të llogarisë korrente. Investimet e huaja direkte neto, këtë tremujor, shënuan një rënie me rreth 47.7% në nivel vjetor. Në anën tjetër, investimet e huaja direkte hyrëse, duke hequr privatizimet me kapital të huaj, të cilat ishin rreth 111 milionë euro gjatë tremujorit të dytë të vitit të kaluar, shënojnë një rritje vjetore prej 4.9%..

Leku ka vazhduar të mbiçmohet në terma nominalë efektivë edhe në tremujorin e tretë. Ky mbiçmim ka ritëm më të ngadaltë se në



gjashtëmujorin e parë të vitit. Indeksi NEER 51, i cili paraqet vlerën e monedhës vendase kundrejt atyre të vendeve kryesore partnere, ra në terma vjetorë me mesatarisht 1.0%, nga 2.2% që shënonte në periudhën janar-qershor 2014. Mbiçmimi i monedhës vendase ndaj dollarit amerikan, veçanërisht gjatë muajve korrik-gusht, ishte faktori kushtëzues i ecurisë së këtij treguesi. Në terma realë, monedha vendase u mbiçmua me 1.9% në bazë vjetore. Për të njëjtën periudhë, diferenciali i inflacionit në vend me atë të vendeve partnere rezultoi në zgjerim, si pasojë e rënies më të shpejtë të inflacionit në vendet partnere tregtare të eurozonës. Mungesa e presioneve nënçmuese ndaj kursit të këmbimit është reflektuar edhe në indeksin e presioneve në tregun valutor, i cili ka vazhduar të pozicionohet nën mesataren e vet afatgjatë.

Kuadri makroekonomik afatmesëm

Skenari bazë i kuadrit makroekonomik mbështetet në linjën aktuale të politikave makroekonomike, në linjën aktuale të politikave e reformave ekonomiko-strukture qeveritare, në sjelljen dhe në bashkëveprimin racional të agjentëve ekonomikë brenda kontureve të ambientit të brendshëm e të jashtëm makroekonomik, i cili duket si më i mundshmi për periudhën afatmesme në vijim. Në kryerjen e këtyre parashikimeve janë ngritur një set supozimesh bazë, si dhe janë përdorur një set i gjerë të dhënash statistikore makroekonomike të gjeneruara prej institucioneve si: Instituti i Statistikave, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Eurostat, Banka Qendrore Evropiane, etj. Këto statistika janë kryesisht në formën e serive kohore me frekuencë vjetore, tremujore e mujore. Kohëzgjatja e tyre e marrë në konsideratë për ndërtimin e këtij kuadri është përgjithësisht që prej vitit 1996. Pasi janë ndjekur të gjitha etapat metodologjike të parashikimit, testimit, analizat krahasuese, statike, dinamike, e pasi kryhen një sërë testesh konsistence, skenari bazë i përfutur synon të paraqesë situatën makroekonomike përgjithësisht më të mundshme e maksimalisht konsistente në aspektin e një ekonomie të plotë e integrale.

Skenari bazë makroekonomik është ngritur në një konsultim të ngushtë me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Sektori real

Dinamika rritëse e aktivitetit ekonomik u ndërpre në tremujorin e dytë të vitit 2014, por faktorët që përcaktuan këtë rënie vlerësohen të jenë kalimtare. Megjithatë, rezultati i dobët i tremujorit të dytë ka sjellë rishikimin për poshtë të pritjeve tona për rritjen ekonomike të vitit 2014. Projektionet e reja sugjerojnë se rritja ekonomike e këtij viti do të jetë lehtësisht mbi nivelin e regjistruar një vit më parë. Në gjykimin e Bankës së Shqipërisë, kushtet monetare stimuluese, reduktimi i primeve të rrezikut, rritja e besimit të agjentëve ekonomikë dhe përmirësimi i ekonomisë botërore, pritet të mbështetin një rritje më të shpejtë gjatë tremujorëve në vijim. Gjithsesi, rreziqet që shoqërojnë këtë skenar mbeten në kahun rënës.

Gjatë vitit 2013, zhvillimet makroekonomike janë karakterizuar nga një rritje shumë e dobët, inflacion i ulët, me baza relativisht të shëndosha financiare, me një përmirësim në llogarinë korrente dhe me një bilanc pozitiv të pagesave, përkeqësim të pozicionit fiskal dhe me pasiguri të larta të perceptuara prej agjentëve ekonomikë. Kërkesa e brendshme ka vazhduar të jetë nën presion në mënyrë të konsiderueshme si rezultat i pasigurive për të ardhmen, pozitive të të ardhurave të familjare, kushteve relativisht të shtrënguara të kreditimit. Komponenti publik i kërkesës së brendshme agregate ka ndihmuar të balancojë konsumin dhe investimet private që ishin disi të ulëta. Njësoj si në vitin 2012, kërkesa e huaj ka vijuar të gjenerojë pothuajse të gjithë rritjen në vitin 2013. E gjithë kjo rezultoi që viti 2013 të shënojë nivelin më të ulët të rritjes ekonomike gjatë pesë viteve të fundit nën presionin e krizës globale, prej 1.4%.

Në të ardhmen, rritja pritet të përshpejtohet disi në vitin 2014, sidomos në pjesën e dytë të vitit. Pasiguritë në lidhje me zgjedhjet elektorale të vitit 2013 priten të veniten, si dhe priten hyrje të kapitalit të huaj nga institucionet financiare ndërkombëtare të cilat do të kanalizohen kryesisht në pagesat e borxheve të qeverisë ndaj sektorit privat. Gjithashtu edhe një përmirësim i mundshëm në ekonominë e eurozonës rrisin gjasat për një rritje më të lartë në vitin 2014 prej 2.1%.

Hendekut i prodhimit pritet që gradualisht të fillojë mbyllet duke nisur që nga viti 2015 dhe duke vazhduar në vitet e ardhshme. Rritja pritet të ketë një bazë më të gjerë, pasi pritet që besimi i



agjentëve ekonomikë të vijë duke u përmirësuar në përputhje me rimëkëmbjen e aktivitetit ekonomik global dhe veçanërisht të Italisë dhe Greqisë. Familjet dhe bizneset do të fillojnë të përfitojnë nga kushtet monetare stimuluese.

Bilanci i jashtëm i ekonomisë mund të vazhdojë të përmirësohet në vitet e ardhshme. Kjo së bashku me konsolidimin e pozicionit fiskal do të mbështesë forcimin e stabilitetit makroekonomik dhe kredibilitetit të perceptuar nga agjentët e tjerë të ekonomisë. Kjo do të çojë në prime të ulëta të rrezikut për ekonominë dhe do të kontribuojë në nxitjen e ndërmjetësimit financiar dhe në një hyrje më të qëndrueshme të flukseve të kapitalit të huaj. Gjithashtu, korrigjimi i vijueshëm i disbalancave në sektorin e jashtëm do të çojë në një përmirësimin të raportit të hendekut ndërmjet kursimeve dhe investimeve në vend.

Pavarësisht pritshmërive për një përshpejtim të ritmeve të rritjes dhe ngushtim të hendekut të prodhimit, ekonomia është parashikuar të vazhdojë të operojë nën potencial, si në periudhën afatshkurtër edhe në atë afatmesme, duke lënë të kuptohet për presione të ulëta inflacioniste nga ana e kërkesës.

PBB: Kërkesa agregate

Konsumi final parashikohet të rritet në terma realë me një normë mesatare vjetore prej 1.5% gjatë periudhës afatmesme në vijim. Në mënyrë të veçantë, rritja reale e konsumit parashikohet në 0.2% në vitin 2014 duke kontribuar me 0.2 pikë përqindje në rritjen ekonomike për këtë vit. Gjatë vitit 2015 rritja e konsumit parashikohet të përshpejtohet në 1.5%, duke kontribuar me rreth 1.3 pp në rritjen reale ekonomike të përgjithshme dhe të rritet me 2.7% në vitin 2016 duke kontribuar me 2.3 pikë përqindje.

Investimet (formimi bruto i kapitalit fiks) gjatë 2014-2017 parashikohet të përjetojnë një rritje vjetore mesatare reale prej 1.5%. Në vitin 2014 investimet parashikohet të tkurren me -0.4 % në terma realë duke kontribuar me -0.1 pp në rritjen e PBB-së. Tkurrja është rrjedhojë e nivelit më të ulët të investimeve publike krahasuar me vitin 2013 prej rreth 9.9% më pak, ndërsa investimet private parashikohen të rriten me rreth 2.3% në terma realë. Në vitin 2015 investimet totale parashikohet të rritet me 4.3% duke kontribuar me 1.2 pp. Në vitin 2016 investimet janë parashikuar të rriten me

5.8% me një kontribut prej 1.0 pikë përqindjeje në rritjen reale ekonomike.

Eksporti neto i mallrave dhe shërbimeve parashikohet të vazhdojë përmirësimin e bilancit të tij neto gjatë periudhës afatmesme. Është parashikuar që për vitin 2014 deficit i mallrave dhe shërbimeve të përmirësohet me 12.2% në terma real, duke kontribuar me 2.0 pikë përqindje në rritjen e PBB-së së parashikuar prej 2.1% për vitin 2014. Përmirësimi i balancës parashikohet të vijojë edhe në vitin 2015 me rreth 5.8% dhe me 2.0 % në vitin 2016, duke kontribuar përkatësisht me 0.8 pikë përqindje dhe 0.3 pp në rritjen ekonomike për këto dy vite. Përmirësimi i eksporteve neto parashikohet të vijë nga një rritje të qëndrueshme të eksporteve të mallrave dhe shërbimeve, por edhe nga ulja e importeve të mallrave dhe zëvendësimi i tyre me ato të prodhuara në vend.

Ndryshimet në inventar janë supozuar me një kontribut neutral (zero pp) në kërkesën agregate dhe rritjen reale të PBB-së.

PBB: Oferta agregate

Sipas optikës së ofertës agregate, ecuria e pritshme sipas aktivitetëve ekonomike kryesore paraqitet si vijon.

Prodhimi bujqësor, duke supozuar kushte normale klimaterike, është projektuar të rritet çdo vit me mesatarisht rreth 4.4% për periudhën e ardhshme 2014-2017, me një kontribut mesatar në rritjen e PBB- së me rreth 0.9 pp në vit.

Prodhimi industrial, duke përfshirë industrinë nxjerrëse dhe atë të prodhimit, parashikohet të rritet mesatarisht me 6.1% në vit për periudhën afatmesme 2014 - 2017, duke kontribuar mesatarisht me 0.7 pikë përqindje në vit në rritjen e parashikuar të PBB-së për çdo vit.

Ndërtimi, për vitin 2014 parashikohet të vijojë me një rënie, ndonëse më e moderuar se vitet e shkuara, ndërsa parashikohet të kthehet në norma pozitive të rritjes për vitet 2015, 2016 dhe 2017. Mesatarisht ndërtimi parashikohet të rritet në terma reale me 1.5% gjatë vitit 2014-2017, duke kontribuar pozitivisht në rritjen e përgjithshme të aktivitetit ekonomik me një mesatare prej 0.1 pp në vit.

Shërbimet janë parashikuar të rriten mesatarisht me 2.7% në vit gjatë periudhës afatmesme 2014-2017, duke kontribuar mesatarisht me 1.4 pp në vit në rritjen e përgjithshme ekonomike. Kontributi kryesor pritet të vijë nga shërbimet e tjera. Tregti,



hotele dhe restorante gjithashtu priten të kenë një kontribut në rritje gjatë gjithë horizontit kohor të ardhshëm.

Bazuar në parashikimet e mësipërme të kërkesës dhe ofertës agregate, skenari bazë i paraqitur *Treguesit kryesorë makroekonomik*

parashikon një rritje reale të PBB-së prej 2.1% në vitin 2014, 3.0% në vitin 2015, 4.0% në vitin 2016 dhe 4.5% në vitin 2017. Në tabelën më poshtë paraqiten parashikimet e treguesve kryesorë makroekonomik për periudhën 2014 – 2017.

Treguesit	Njësia	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
				Vler.	Para.	Para.	Para.	Para.
Popullsia	Milion	2.9	2.9	2.9	2.9	2.9	2.9	2.9
Inflacioni (mesatar)	%	3.5	2.0	1.9	1.9	2.6	3.0	3.0
Deflatori i PBB	%	2.3	1.0	0.8	1.4	2.5	2.8	3.0
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / USD	100.9	108.2	105.7	105.0	105.0	105.0	105.0
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / Euro	140.5	139.0	140.3	140.0	140.0	140.0	140.0
Faktori i Konvertimit sipas Paritetit të Fuqisë Blerese (PPP)	Lek / USD	45.5	45.5	45.5	45.5	45.5	45.5	45.5
Rritja reale e PBB	%	2.5	1.6	1.4	2.1	3.0	4.0	4.5
PBB	Lek miliardë	1,300.6	1,335.5	1,365.6	1,413.4	1,492.1	1,596.0	1,718.1
PBB	USD miliardë	12.9	12.3	12.9	13.5	14.2	15.2	16.4
PBB	Euro miliard	9.3	9.6	9.7	10.1	10.7	11.4	12.3
PBB për banor	Lek mijë	447.4	460.2	471.1	488.0	515.2	551.1	593.3
PBB për banor	USD	4,433.6	4,253.5	4,457.5	4,648.1	4,906.9	5,248.8	5,650.2
PBB për banor	Euro	3,183.7	3,311.0	3,358.4	3,486.0	3,680.2	3,936.6	4,237.6
PBB për banor	USD-PPP	9,841.4	10,123.2	10,363.5	10,736.5	11,334.5	12,124.3	13,051.4
Norma e papunësisë	%	14.3	14.1	17.1	17.5	16.5	15.3	13.9
Të ardhurat totale	% të PBB	25.4	24.7	24.0	26.0	27.8	27.6	27.7
Shpenzimet totale	% të PBB	28.9	28.2	28.9	31.2	31.8	30.6	29.0
Bilanci i përgjithshëm	% të PBB	-3.5	-3.4	-4.9	-5.2	-4.1	-3.0	-1.3
Bilanci primar fiskal	% të PBB	-0.4	-0.3	-1.7	-2.4	-0.6	0.4	2.0
Bilanci korrent fiskal	% të PBB	1.9	1.2	-0.1	1.2	1.8	3.1	3.9
Huamarrje totale neto	% të PBB	3.5	3.5	4.1	5.2	4.0	3.0	1.3
Borxhi Publik Total	% të PBB	59.4	62.1	70.0	70.9	70.6	68.5	65.5
Borxhi publik i qeverise se pergjithshme	% të PBB	55.7	58.1	61.0	64.1	64.7	63.5	60.3
Borxhi publik jashte treguesve fiskale	% të PBB	3.7	4.0	9.0	6.8	5.9	5.0	5.2

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave, Banka Botërore

Politikat tatimore dhe parashikimi i të ardhurave tatimore për periudhën afatmesme

Në parashikimin e të ardhurave për buxhetin e shtetit të miratuar për vitin 2014 janë mbajtur në konsideratë vlerësimet për ecurinë e ekonomisë, të ardhurat e pritshme nga miradministrimi dhe efektet e paketës fiskale për vitin 2014.

Totali i të ardhurave për 2014 është planifikuar në nivelin e 367.9 miliardë lekë, me një rritje prej 12.5 për qind kundrejt të ardhurave të buxhetit të rishikuar për vitin 2013, ose në nivelin 26.0 për qind të PBB-së, nga ku:

- Të ardhurat nga tatimet e doganat parashikohet të jenë 260.5 miliardë lekë, me një rritje prej 13.7 për qind krahasuar me buxhetin e rishikuar të vitit 2013, ose rreth 18.4 për qind të PBB-së;

- Të ardhurat nga fondet speciale, ku përfshihen kontributet e sigurimeve shoqërore e

shëndetësore dhe të ardhurat për kompensimin në vlerë të pronarëve parashikohen në 63.5 miliardë lekë, me një rritje prej 5.9 për qind krahasuar me buxhetin e rishikuar për vitin 2013, ose rreth 4.5 për qind e PBB-së;

- Parashikimi për të ardhurat nga pushteti lokal për vitin 2014 është 12.8 miliardë lekë, me një rritje prej 18.0 për qind kundrejt buxhetit të rishikuar për vitin 2013, ose 0.9 për qind e PBB-së;

- Të ardhurat jotatimore parashikohen në masën 22.6 miliardë lekë, ose 1.6% të PBB-së;

Të ardhurat nga ndihmat parashikohen rreth 8.5 miliardë lekë, ose 0.6 për qind e PBB-së.

Sipas zërave parashikimi për 2014 është si vijon.

Të ardhurat nga TVSH-ja

Të ardhurat në total nga TVSH-ja parashikohen në nivelin 125.8 miliardë lekë, me rritje 12.4 për qind kundrejt buxhetit të rishikuar



për vitin 2013, ose rreth 8.9 për qind të shprehura si raport ndaj PBB-së. Parashikimi për TVSH-në bazohet në pritshmërinë e aktivitetit ekonomik për sektorë të veçantë të ekonomisë, në parashikimet e nivelit nominal të importeve, në prirjen historike të koeficientit të elasticitetit të këtyre të ardhurave ndaj nivelit nominal të importeve të mallrave, si dhe në pritshmëritë lidhur me përmirësimin administrativ në mbledhjen e kësaj takse. Efekt në të ardhurat e pritshme do të ushtrojnë dhe politikat tatimore, të analizuara në detaj më lart.

Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin

Të ardhurat në total për tatim-fitimin janë parashikuar në 21.9 miliardë për vitin 2014, nga 15.1 mld lekë të pritshme për vitin 2013. Në raport me PBB-në, të ardhurat nga tatimi mbi fitimin arrijnë në rreth 1.5 për qind. Parashikimi për këtë zë është bazuar në parashikimin për rritjen e bazës së tatueshme e lidhur kryesisht me ecurinë e aktivitetit ekonomik, si dhe të përmirësimeve të pritshme në aspektin administrativ. Efekti i ndryshimit të normës tatimore (siç analizohet më lartë) është rreth 7 miliardë lekë për vitin 2014.

Të ardhurat nga akciza

Të ardhurat që parashikohet të mblidhen nga akciza për vitin 2014, janë rreth 44.5 miliardë lekë, me rritje vjetore 16.7 për qind kundrejt buxhetit të rishikuar për vitin 2013, ose në nivelin 3.1 për qind të PBB-së. Efektin dominues në rritjen e të ardhurave e ka rritja e nivelit të taksimit për disa nga mallrat kryesorë me akcizë në Republikën e Shqipërisë, si: cigaret, duhani me të dredhur, pijet alkoolike dhe birra.

Tatimi mbi të ardhurat personale

Nga tatimi mbi të ardhurat personale parashikohet një nivel të ardhurash prej 28.2 miliardë lekë ose 4.6% më pak për qind se vlera e buxhetit të rishikuar për vitin 2013. Në raport me PBB-në, të ardhurat arrijnë në rreth 2.0 për qind. Të ardhurat do të ndikohen kryesisht nga reformimi i taksimit mbi pagat, nga tatim i sheshtë në tatim progresiv, siç shpjegohet më lart. Efekti në të ardhura i reformës tatimore për TAP-in vlerësohet në 1.5 miliardë më pak në terma vjetorë.

Të ardhurat nga taksat nacionale dhe të tjera

Të ardhurat nga taksat nacionale për vitin 2014 parashikohet të jenë rreth 34.1 miliardë lekë, me rritje 20.0 për qind ndaj buxhetit të rishikuar për vitin 2013 (ose 2.4 për qind e PBB-së).

Parashikimet për të ardhurat nga kjo taksë janë bazuar në parashikimet e rritjes së aktivitetit ekonomik, parashikimet për ecurinë e eksporteve, të cilat ndikojnë në mënyrë direkte të ardhurat nga renta minerare, trendi historik i rritjes së tyre dhe pritshmëria për përmirësimin administrativ në mbledhjen e saj. Efekt do të ushtrojë rritja e taksës së qarkullimit mbi benzinën dhe gazolin, e vlerësuar në rreth 5.5 miliardë lekë shtesë për vitin e ardhshëm.

Të ardhurat nga taksa doganore

